



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 21.11.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:45 dhe mbaroi në orën 13:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 7. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 8. Vjollca Kola, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Elisma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Rudina Palloj, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 11. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 12. Anisa Kuqi, EURALIUS.*
- 13. Julinda Beqiraj, EURALIUS.*
- 14. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 15. Erion Fejzulla, USAID.*
- 16. Gregor Borkowski, EURALIUS.*
- 17. Chuck Ericksen, USAID.*
- 14. Përfaqësues të medias. (Kameramanët prezent vetëm në prezantimin e rendit të ditës).*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje!

Po fillojmë me mbledhjen e datës 21 nëntor të 2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Jemi të pranishëm të gjithë anëtarët e Këshillit.

Sot në rendin e ditës në mbledhje janë 4 çështje të rëndësishme, ku dy prej tyre unë do doja të ndalesha, duke përfituar edhe nga prezenca e medias.

Sot Këshilli do marrë në shqyrtim dy rregullore shumë të rëndësishme. Rregullorja e parë ka të bëjë me “Miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe Rregullorja e dytë ka të bëjë me “Metodologjinë e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarëve”. Të dyja këto rregullore janë akte të cilat për nga rëndësia mund të themi që janë shumë të rëndësishme, jo vetëm për Këshillin, por për të gjithë sistemin. Janë dy akte që vijnë pas një pune voluminoze disamujore të anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, të mbështetur edhe nga ekspertët e projektit EURALIUS.

Këto akte i janë nënshtruar një konsultimi të brendshëm dhe të jashtëm. I janë nënshtruar një konsultimi të jashtëm sepse janë marrë mendimet e të gjithë ekspertëve ndërkombëtarë, përfshirë edhe Këshillin e Evropës. Gjithashtu i janë nënshtruar konsultimit të brendshëm me të gjithë trupën gjyqësore, duke marrë në konsideratë të gjithë sugjerimet për sa i përket përmirësimit të projekt-akteve.

Gjej rastin në falënderoj dhe përgëzoj anëtarët e Komisionit dhe ekspertët e projektit EURALIUS për punën cilësore dhe të palodhur për hartimin e këtyre akteve. Me miratimin e këtyre projektvendimeve të sotshëm, KLGJ-ja i hap rrugë vlerësimit të të gjithë gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë, plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën e Lartë nga radhët e gjyqësorit, plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, zgjedhjen e kryetarëve të të gjithë

gjykatave, nisjen e procedurave të lëvizjeve paralele të gjyqtarëve në gjykata të ndryshme. Miratimi i këtyre projekt-akteve mundëson ngritjen në detyrë në shkallë të lartë apo në gjykatat e specializuara promovimi mbi bazën e kritereve objektive, etike-profesionale, organizative dhe angazhimit profesional.

Atëherë, për më shumë detaje, unë do doja që kamerat të vazhdonin dhe të kalonim në diskutimin e akteve konkrete.

(Kameramanët largohen nga salla e mbledhjes.)

Atëherë, vazhdojmë sipas rendit të ditës.

Fjalën ia jap zonjës Brikena Ukperaj, lidhur me relatimin e projekt-aktit të parë që ka të bëjë me “Miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”.

Brikena Ukperaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bazë dhe për zbatim të nenit 147/a të Kushtetutës dhe neneve 68-99 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ka detyrimin për kryerjen e vlerësimit etik dhe profesional periodik të gjyqtarëve. Ky proces vlerësimi synon të, së pari përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme etikën dhe aftësinë profesionale të gjyqtarëve; të vendosë standarde të qëndrueshme për cilësinë dhe sasinë e veprimtarisë së gjyqtarëve; zhvillojë karrierën e gjyqtarit bazuar në meritat profesionale, duke identifikuar gjyqtarët që kanë aftësi të veçanta profesionale, si dhe; identifikojë nevojat për trajnim profesional të gjyqtarëve me qëllim planifikimin efektiv të procesit të trajnimit vazhdues si dhe për dhënien e kontributit në përmirësimin e strukturës organizative dhe funksionalitetin e gjykatave.

Tërësia e rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit përbëjnë Skemën e Vlerësimit.

Një pjesë e këtyre rregullave janë të parashikuara në ligjin 96/2016, nga nenet 68-99 të këtij ligji. Ndërkohë që rregullat plotësuese të skemës së vlerësimit të gjyqtarëve në detyrë, janë pjese e disa akteve nënligjore që KLGJ duhet të miratojë e që përcaktojnë:

Rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve; Metodologjinë e pikëzimit me

qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit; Rregullat për zhvillimin e procedurave të shortit për përzgjedhjen e dosjeve gjyqësore e dokumentimin e tij; Tabelat e standardizuara me të dhënat statistikore të nevojshme për procesin e vlerësimit; Përmbajtjen e formën e formularit të vetëvlerësimit të gjyqtarit; Përcaktimin e standardeve për mendimin e kryetarit të gjykatës, bashkë me përgatitjen e një formulari të gatshëm për dokumentimin e mendimit të kryetarit; Standardet e reja matëse të treguesve që lidhen me aftësitë organizative të gjyqtarit; Format standarde të mënyrës se si hartohet raporti analitik, projektraporti i vlerësimit dhe i ekstraktit të nevojshëm për publikimin e vendimit përfundimtar të vlerësimit.

Veç rregullave të mësipërme, KLGJ duhet të miratojë dhe rregulla plotësuese të skemës së vlerësimit, për ndihmës magjistratët në Gjykatën e Lartë, gjyqtarët në skemë delegimi apo ata të komanduar në Këshill, bashkë me ato të nevojshme për vlerësimin e veprimtarisë së kryetarëve.

Akti që i propozohet sot për miratim mbledhjes plenare i titulluar “Rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, ka për objekt: “Përcaktimin e rregullave që plotësojnë skemën e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve në bazë dhe për zbatim të ligjit 96/2016, me qëllim vlerësimin e gjyqtarëve të caktuar në një pozicion në gjykatë, të cilët kanë ushtruar detyrën e gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit. Këto rregulla janë hartuar për të plotësuar skemën e vlerësimit të përcaktuar në ligj, duke respektuar parimet e pavarësisë, meritokracisë dhe zhvillimit të karrierës, efikasitetit, procesit të rregullt ligjor dhe konfidencialitetit, parashikuar në nenin 69 të ligjit për Statusin.

Në hartimin e rregullave plotësuese i është kushtuar vëmendje e veçantë: respektimit të parimeve të vlerësimit dhe parimeve të zhvillimit të procesit të vlerësimit etik dhe profesional, të parashikuara në ligj; respektimit me korrektësi të normave ligjore që rregullojnë skemën e vlerësimit të gjyqtarëve, duke qenë se ligjvënësi ka zgjedhur aplikimin e një sistemi formal të vlerësimit; kujdesit për mos përsëritjen e dispozitave ligjore që rregullojnë skemën e vlerësimit në aktin nënligjor dhe konceptimin e këtij të fundit si një akt plotësues për skemën e vlerësimit të përcaktuar me ligj; krijimin e një procesi vlerësimi të qartë, të kuptueshëm, të thjeshtë dhe të zbatueshëm pa vështirësi

nëpërmjet parashikimit të rregullave të qarta dhe miratimin e akteve model të cilat plotësohen gjatë procedurës së vlerësimit; përcaktimin e fazave të procesit të vlerësimit duke bërë një ndarje të qartë në aspektin procedural të procesit në pesë faza kryesore, referuar llojit të procedurës që zhvillohet, subjekteve që marrin pjesë dhe natyrës së veprimtarisë në secilën fazë, saktësimin e detyrave, përgjegjësi dhe procedurave që ndjek çdo subjekt që merr pjesë në procedurën e vlerësimit; së gjashti përcaktimin si prioritet në vlerësim, përfundimin e vlerësimit të gjyqtarëve që kalojnë procesin e rivlerësimit kalimtar me qëllim gradimin e tyre si dhe vlerësimin e përshpejtuar të detyruar të gjyqtarëve për efekt të lëvizjes paralele ose ngritjes në detyrë me qëllim garantimin e funksionalitetit të gjykatave gjatë periudhës kalimtare.

Siç kundër edhe ju Kryetare e relatuar, ky projekt-akt ka kaluar në disa faza përgatitjeje, gjatë së cilave drafti është përmirësuar deri në këtë version që paraqitet sot për miratim. Projekt-akti është draftuar nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale në grup pune me ekspertë të misionit mbështetës EURALIUS, dhe iu është dërguar paraprakisht për mendim të gjithë gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë. Me ndihmën e USAID dhe EURALIUS, janë organizuara dy tryeza të rrumbullakëta diskutimi me gjyqtarë të shkallës së parë dhe ata të apelit të juridiksionit të përgjithshëm e atyre të posaçëm, të cilët kanë dhënë mendimet e kundërshtimet e tyre, një pjesë e të cilave janë reflektuar në dispozitat e këtij projekt-akti. Mendime në lidhje me draftin e hartuar kanë dhënë edhe ekspertë të Këshillit të Evropës, referuar standardeve të përcaktuara nga CEPEJ dhe Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë. Mendim për projekt-aktin kanë dhënë edhe disa inspektorë që vazhdojnë akoma ushtrojnë detyrën pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe që janë marrë në mënyrë periodike me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve.

Projektvendimi për “Rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” është organizuar në disa krerë të cilët përfshijnë dispozitat e mëposhtme:

Në Kreun I janë përcaktuar dispozitat e përgjithshme të rregullave plotësuese, konkretisht: Në nenin 1 gjen pasqyrë objekti i këtij vendimi. Sikundër e citova edhe më lart, përcaktimi i objektit të këtij vendimi mban në vëmendje faktin që në ligj janë

përcaktuar rregulla të detajuara për skemën dhe procesin e vlerësimit të gjyqtarit për të cilat vendimi përkatës referon në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke respektuar hierarkinë e normave dhe parimin e ligjshmërisë si dhe kujdesin për mos dublimin ose përsëritjen e normave ligjore në nenet e aktit nënligjor, përveç rastit kur kjo është e nevojshme.

Në nenin 2 është detajuar fusha e zbatimit. Ky vendim zbatohet për vlerësimin periodik të gjyqtarit në një pozicion të caktuar në gjykatë dhe që ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit. Rregullat e detajuara që plotësojnë skemën e vlerësimit për gjyqtarët e komanduar në skemë delegimi, gjyqtarët ndihmës magistratë apo edhe kryetarët e gjykatave do të përcaktohen me akte të veçanta të Këshillit. Për gjyqtarët e komanduar në institucione të tjera ligji ka parashikuar që vlerësimi bëhet nga vetë institucioni sipas rregullave që parashikon vetë ai për mënyrën e vlerësimit të veprimtarisë që kryen aty magistrati.

Në pikën 3 të nenit 2 është përcaktuar përjashtimi nga fusha e vlerësimit, pikërisht i gjyqtarëve që ushtrojnë funksionin si të komanduar në pozicione të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2 të nenit 3 dhe mënyrën se si procedohet me vlerësimin e veprimtarisë së tyre profesionale, duke patur parasysh që nëse vlerësimi nuk kryhet nga institucioni, përsëri Këshilli ka autoritetin për të bërë vlerësimin po sipas një rregulloreje tjetër që ne kemi miratuar për pikëzimin e juristëve të spikatur që kandidojnë për Gjykatën e Lartë.

Në nenin 3 të projektvendimit janë përcaktuar përkufizimet për termat e përdorura në vendim, për të garantuar kuptimin dhe zbatimin e njëjtë dhe të drejtë të tyre, duke marrë parasysh kuptimin e përcaktuar në ligj për secilin term në veçanti, në rastet kur ligji ka përkufizuar kuptimin e termit në nenin 2 të tij ose kuptimit të termit, referuar dispozitave të veçanta të ligjit për Statusin.

Në nenin 4 janë përcaktuar parimet në të cilat zbatohet procedura dhe sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve, duke iu referuar nenit 69 të ligjit.

Neni 5 i projektvendimit bën rregullime specifike për përcaktimin e periudhës së vlerësimit në zbatim të nenit 84, pika 1 dhe 2 të ligjit për Statusin, konkretisht: Pika 1 e nenit 5 të projektvendimit është dispozitë referuese për shkak se periudha e vlerësimit për

çdo tre ose pesë vjet, përcaktohet në bazë të viteve të përvojës profesionale.

Pika 2 e nenit 5 përcakton përjashtimin e periudhës së lejes së papaguar si periudhë profesionale për efekt të përcaktimit të periudhës së vlerësimit për shkak se gjatë lejes së papaguar gjyqtari nuk kryen funksione gjyqësore dhe kjo periudhë nuk njihet si periudhë vjetërsie në punë dhe për pasojë, nuk ka veprimtari që të përbëjë objekt vlerësimi etik dhe profesional të gjyqtarit, në përputhje edhe me nenin 24, pika 5 të ligjit për Statusin.

Pika 3 e nenit 5 parashikon se periudha e vlerësimit 3 ose 5-vjeçare përbehet nga vite kalendarike dhe fillon në datën 1 janar të vitit të parë të periudhës së vlerësimit.

Pika 4 e nenit 5 përcakton një afat minimal gjatë së cilit gjyqtari duhet të ketë ushtruar detyrën brenda periudhës së vlerësimit, i cili nuk mund të jetë më pak se 1 vit. Përcaktimi i këtij kufiri kohor minimal bëhet për të mundësuar kryerjen efektive të vlerësimit me të dhëna dhe materiale të nevojshme për vlerësim.

Në nenin 6 të projektvendimit përcaktohet mënyra e vlerësimit të gjyqtarit duke referuar kriteret e vlerësimit sipas treguesve të përcaktuar në metodologjinë e vlerësimit, standardet për matjen e treguesve ligjore në raport me pozicionin e gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit. Mënyra e vlerësimit e përcaktuar këtë nen, referuar në metodologjinë e vlerësimit, skemën e pikëzimit dhe standardet e matjes së treguesve ligjore që miratohen nga Këshilli, janë përcaktuar duke mbajtur parasysh parimet e hartimit dhe zbatimit të sistemit së vlerësimit të përcaktuara në nenin 69 të ligjit për Statusin dhe nenin 4 të vendimit, si dhe kriterëve të vlerësimit të përcaktuara në nenet 71, 72, 74, 75 dhe 76 të ligjit. Në këtë dispozitë parashikohet rregulli i formalizimit të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, duke dokumentuar me shkrim çdo veprim që do të kryhet nga subjektet pjesëmarrës në procesin e vlerësimit. Përcaktimi i këtij rregulli ka për qëllim garantimin e parimit të procesit të rregullt ligjor gjatë procedurës së vlerësimit, rregullsinë e procesit të vlerësimit dhe zbatimin e standardeve dhe rregullave procedurale të njëjta dhe të unifikuara për të gjithë gjyqtarët gjatë procedurës së vlerësimit.

Në nenin 7 përcaktohet situata e përfundimit të procedurës së vlerësimit pa

vendim përfundimtar në rast të mbarimit të statusit të magjistratit në referim të nenit 64 të ligjit për Statusin dhe nenit 90 të Korit të Procedurës Administrative.

Në nenin 8 të projektvendimit përcaktohet roli dhe detyrat e relatorit në procesin e vlerësimit. Në hartimin e përmbajtjes së kësaj dispozite është mbajtur në vëmendje fakti që pozicioni dhe funksionet e relatorit janë përcaktuar në ligj. Sipas parashikimeve të nenit 89 të ligjit për Statusin është përcaktuar se procedura e vlerësimit zhvillohet nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e relatorit, të caktuar me short sipas nenit 3 shkronja “ë” të këtij vendimi.

Në pikën 1 të nenit 8 të projektvendimit përcaktohet roli i relatorit si përgjegjës për zhvillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit si dhe roli i Komisionit gjatë zhvillimit të procedurës së vlerësimit.

Në nenin 8 shkronja “a” parashikohet detyra e relatorit për njoftimin e gjyqtarit dhe kryetarit të gjykatës për fillimin e procedurës së vlerësimit. Ky njoftim ka për qëllim marrjen dijeni të subjekteve për fillimin e procedurës, fillimin e afatit ligjor për plotësimin e formularit të vlerësimit nga ana e gjyqtarit dhe përgatitjen e mendimit nga ana e kryetarit dhe përgatitjen e statistikave të nevojshme për vlerësim si dhe përgatitjen e bazës së të dhënave mbi të cilat do të organizohet procedura e shortit.

Në nenin 8 shkronja “b” përcaktohet përgjegjësia e relatorit për zhvillimin e procedurës paraprake që konsiston në kryerjen e detyrave të përcaktuara në nenin 89, 90 , 91 dhe 92 të Ligjit për Statusin dhe ato të përcaktuara në këtë vendim, duke përfshirë administrimin e formularit të vlerësimit të gjyqtarit, formularin e mendimit të kryetarit të gjykatës dhe procesverbalin e kundërshtimit të gjyqtarit për mendimin e kryetarit, dokumentacionin e marrë në bazë të procedurës së shortit dhe dokumentacionin e marrë nga institucionet e tjera si Shkolla e Magjistraturës, ILD dhe ILDKPKI, etj.

Në neni 8 shkronja “c” është përcaktuar roli mbikëqyrës i relatorit në krijimin e dosjes së vlerësimit sipas përcaktimeve të nenit 90 të ligjit për Statusin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e zhvillimit të procedurës së shortit, si dhe mbikëqyrjen e procesit të përgatitjes së raportit analitik. Roli mbikëqyrës i relatorit në procesin e krijimit të dosjes dhe hartimin e raportit analitik është përcaktuar duke mbajtur në vëmendje përcaktimet e

neneve 90, 91 dhe 92 të ligjit për Statusin. Gjithashtu përcaktohet roli mbikëqyrës i relatorit në hartimin e raportit analitik nga nëpunësi përgjegjës sipas parashikimit të nenit 91, pika 2 të ligjit për Statusin në të cilin parashikohet se: ”2. Çdo akt i marrë gjatë procedurës së vlerësimit, sipas këtij ligji, përfshihet në dosje dhe listohet në një raport i cili analizon në mënyrë të detajuar dhe të strukturuar të dhënat”.

Roli mbikëqyrës dhe kontrollues i relatorit në këtë fazë të procesit të vlerësimit ka për qëllim organizimin me efikasitet dhe në përputhje me ligjin të veprimtarisë paraprake të procesit të vlerësimit, me qëllim krijimin e dosjes së plotë së vlerësimit, organizimin dhe zhvillimin e procedurave të shortit, komunikimin me gjyqtarin, kryetarin e gjykatës dhe institucionet e tjera në përputhje me parashikimet e ligjit dhe rregullat e përcaktuara në këtë vendim.

Më tej, në të njëjtën dispozitë është përcaktuar përgjegjësia e relatorit për njoftimin e kryetarit të Komisionit për krijimin e dosjes së vlerësimit dhe përgatitjen e raportit analitik me qëllim realizimin e procedurës së kontrollit për plotësinë dhe rregullsinë e dosjes së vlerësimit dhe raportit analitik nga Komisioni, para hartimit të projektraportit të vlerësimit.

Në shkronjën “d” të nenit 8 përcaktohet përgjegjësia e relatorit në hartimin e projektraportit të vlerësimit, si një nga përgjegjësitë ligjore ekskluzive e tij në referim të nenit 93, pika 1 të ligjit për Statusin.

Në pikën 2 të nenit 8 parashikohet së relatori në kryerjen e funksioneve të tij mbështetet nga administrata e Këshillit, parashikim ky që buron drejtpërdrejt nga ligji. Struktura administrative e Këshillit dhe nëpunësi përgjegjës për vlerësimin, gjatë procedurës së vlerësimit, prej fillimit të tij deri në momentin e hartimit të raportit analitik, vepron nën drejtimin dhe kontrollin e relatorit duke kryer çdo detyrë që ka lidhje me procesin e vlerësimit të përcaktuar nga relatori.

Në nenin 9 të projektvendimit është përcaktuar roli i Komisionit gjatë zhvillimit të procedurës së vlerësimit. Në këtë nen përcaktohet faza në të cilën Komisioni ushtron funksionet e tij (dhe bëhet fjalë për Komisionin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale) gjatë procesit dhe konkretisht, pas hartimit të raportit analitik nga nëpunësi përgjegjës

dhe para hartimit të projektraportit të vlerësimit nga relatori. Komisioni, i njoftuar nga relatori, sipas nenit 8, pika 1 shkronja “ç”, vlerëson nëse dokumentacioni i dosjes së vlerësimit është i plotë dhe përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për vlerësim. Në rast se Komisioni vlerëson se dosja nuk është e plotë, i kërkon relatorit marrjen e të dhënave të tjera nga burimet e vlerësimit. Roli kontrollues i Komisionit për rregullsinë e procedurës dhe plotësinë e dosjes së vlerësimit, para hartimit të projektraportit të vlerësimit, ka për qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt dhe të plotë vlerësimi, duke qenë se shkelja e procedurës së vlerësimit përbën shkak për ankim ndaj vendimit që miraton projektraportin e vlerësimit të hartuar nga relatori. Pasi Komisioni të ketë vlerësuar se dosja është e plotë dhe raporti analitik përfshin të gjitha të dhënat e kërkuara, relatori mund të vijojë procedurën e vlerësimit për hartimin e projektraportit të vlerësimit.

Kreu II i projektvendimit përbëhet nga tetë nene që strukturojnë procedurën e vlerësimit etik dhe profesional. Struktura e përcaktuar për zhvillimin e procedurës së vlerësimit ndjek një rend kronologjik të fazave të zhvillimit të procedurës së vlerësimit duke synuar të normojë në mënyrë të saktë ecurinë e procedurës së vlerësimit të parashikuar në nenet 85-95 të ligjit për Statusin, duke përcaktuar qartë fazat e zhvillimit të procesit, afatet e zhvillimit të tij, subjektet përgjegjës për çdo fazë të procesit, detyrat e secilit prej tyre dhe të drejtën e pjesëmarrjes së gjyqtarit gjatë zhvillimit të procesit të vlerësimit.

Përcaktimi i fazave të zhvillimit të procesit të vlerësimit synon krijimin e një skeme të kuptueshme, funksionale dhe efektive për zhvillimin e procedurës së vlerësimit dhe respektimin e parimit të procesit të rregullt ligjor për gjyqtarin që vlerësohet.

Në nenin 10 të projektvendimit përcaktohen në rend kronologjik fazat në të cilat zhvillohet procesi i vlerësimit dhe veprimtarisë kryesore që zhvillohet në secilën fazë. Konkretisht përcaktohet se procesi i vlerësimit zhvillohet në gjashtë faza kryesore të cilat detajohen më tej në nenet vijuese, nga neni 11 deri në nenin 16 të vendimit. Përcaktimi i fazave të zhvillimit të procedurës së vlerësimit është strukturuar duke patur në vëmendje krijimin e një procedure në rend kronologjik dhe funksional ku mbyllja e secilës fazë determinon fillimin e fazës tjetër të procedurës së vlerësimit.

Faza e parë ka të bëjë me miratimin e programit vjetor nga ana e Këshillit, zhvillimin e procedurës së shortit dhe caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin.

Faza e dytë e procedurës ka të bëjë me veprimtarinë e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për mbledhjen e dokumentacionit dhe krijimin e dosjes së vlerësimit.

Faza e tretë e vlerësimit përkon me hartimin e raportit analitik nga nëpunësi përgjegjës për vlerësimin.

Faza e katërt e procedurës përkon me rolin e Komisionit në procedurën e vlerësimit.

Dhe faza e pestë e procedurës së vlerësimit konsiston në hartimin e projektraportit të vlerësimit dhe njoftimin e tij gjyqtarit që vlerësohet si dhe administrimin e kundërshtimeve me shkrim që mund të dërgohen prej tij. Kjo fazë zhvillohet nga relatori i cili është subjekti përgjegjës sipas parashikimeve të ligjit.

Pas përfundimit të fazës së mësipërme vijon faza e gjashtë e procesit të vlerësimit që konsiston në shqyrtimin e projektraportit të vlerësimit në mbledhjen plenare dhe vendimmarrjen e Këshillit për vlerësimin e gjyqtarit.

Fazat e mëtejshme nuk është e nevojshme sepse unë në mënyrë të detajuar i përmenda. Fillojnë me nenin 11 të projekt-aktit (sipas pikave që ka përcaktuar ky nen). Parashikohen të gjithë detyrat e Këshillit dhe Komisionit në hartimin e projektprogramit të vlerësimit vjetor, duke synuar që të përfshijnë në këtë projektprogram vlerësimi të gjithë gjyqtarët të cilët janë në kushte të njëjta në lidhje me periudhën e vlerësimit, me qëllim realizimin e vlerësimit etik dhe profesional në kohën e duhur.

Në nenin 12 të projektvendimit parashikohet procedura që ndjek Këshilli për zbatimin e programit vjetor të vlerësimit duke parashikuar miratimin e planeve tremujore, brenda programit vjetor të miratuar të vlerësimit, caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës, bashkë me detajimet se si ndodh e gjithë procedura nëse kërkohet përjashtimi i njërit prej tyre.

Faza e dytë – Në nenin 13 të projekt-vendimit përcaktohet procedura dhe afatet e mbledhjes së dokumentacionit të nevojshëm për krijimin e dosjes së vlerësimit dhe për

procedurën e zhvillimit me short. Parashikimet e këtij neni referojnë në përcaktimet ligjore të nenit 85 pika 3 dhe 4, nenit 86-88 të ligjit për Statusin.

Në pikën 3 të nenit 13 përcaktohen më konkretisht të dhënat dhe treguesit mbi bazën e të cilave relatori përcakton me vendim numrin e çështjeve që do të përzgjidhen me short. Ky nen referohet në nenin 91 të ligjit për Statusin në të cilin janë të përcaktuar në mënyrë të detajuar rregullat për përcaktimin e numrit të dosjeve që përzgjidhen dhe kriteret e përcaktimit të këtij numri.

Data e zhvillimit të shortit caktohet nga relatori me vendim dhe i njoftohet kryetarit dhe kancelarit, me qëllim që të marrin masa organizative për të krijuar kushtet e nevojshme për zhvillimin e procedurës së shortit, i cili zhvillohet në praninë e detyrueshme të nëpunësit përgjegjës për vlerësimin.

Zhvillimi i procedurës së përzgjedhjes me short, nëse është e mundur, është parashikuar në vendim të zhvillohet në rrugë elektronike dhe nëse kjo nuk është e mundur, më tej vazhdohet në mënyrë manuale, duke mundësuar një procedurë të shpejtë, transparente, objektive dhe tërësisht rastësore për përzgjedhjen e çështjeve që do të bëhen pjesë e dosjes së vlerësimit.

Në pikën 6 të nenit 13 parashikohet detyrimi për dokumentimin e procedurës së zhvillimit të shortit me një procesverbal sipas formës standarde që do të miratohet nga ana e Këshillit.

Neni 14 i projektvendimit përcakton rregulla për krijimin e dosjes së vlerësimit, afatet dhe detyrat e relatorit dhe punonjësit përgjegjës për krijimin, administrimin dhe përpunimin e të dhënave të dosjes së vlerësimit.

Pas përfundimit dhe krijimit të dosjes së vlerësimit, fillon faza e tretë e cila ka të bëjë me momentin kur hartohet projektraporti i vlerësimit. Në vendim është përcaktuar një afat 2-javor, nga momenti i krijimit të dosjes, për nëpunësin përgjegjës me qëllim hartimin e raportit analitik. Hartimi i këtij raporti bëhet nën mbikëqyrjen e relatorit sipas një forme standarde që do të miratohet nga Këshilli.

Pas miratimit të raportit të vlerësimit, fillon faza e katërt dhe faza e pestë. Në nenin 15 të projekt-vendimit përcaktohet veprimtaria e Komisionit duke u konkretizuar

roli i tij, sikundër u relatua edhe më lart, në kontrollin e plotësisë së dokumentacionit të dosjes së vlerësimit.

Në varësi të vendimit që do të marri Komisioni për vazhdimin e procedurës ose për plotësinë e dokumentacionit, relatori mandej ka afatin e vet dyjavor për të përgatitur projektraportin e vlerësimit, i cili i njoftohet gjyqtarit dhe në varësi pastaj të kundërshtimeve të tij, i përcillet për shqyrtim mbledhjes plenare.

Faza e fundit është faza e gjashtë. Rregullohet në nenin 16 të projektvendimit. Është faza ku përfundon procesi i vlerësimit. Zhvillohet në mbledhje plenare dhe finalizohet me vendimmarrjen e Këshillit.

Në pikën 1 dhe 2 të nenit 16 janë përcaktuar rregullat e shqyrtimit të projekt-aktit në mbledhje plenare, njoftimi paraprak i projektraportit anëtarëve dhe mundësia e secilit prej tyre për t'u njohur me dosjen e vlerësimit.

Në këtë dispozitë përcaktohet procedura e shqyrtimit të projektraportit në rastet kur gjyqtari nuk ka kërkuar të dëgjohet. Në këto raste shqyrtimi i çështjes bëhet mbi bazën e relatimit të çështjes nga relatorit. Pas relatimit, anëtarët mund t'i drejtojnë relatorit pyetje për të cilat ai përgjigjet bazuar në të dhënat e administruara në dosjen e vlerësimit.

Gjatë procedurës së shqyrtimit të projektraportit, gjyqtari mund të jetë prezent nëse ai ka kërkuar të dëgjohet. Në këtë rast parashikohet se shqyrtimi i çështjes fillon me relatorin. Më pas dëgjoen shpjegimet e gjyqtarit. Pasi dëgjoet gjyqtari, çdo anëtar mund të bëjë pyetje për relatorin dhe gjyqtarin. Në këtë pikë parashikohet mundësia për t'u dëgjuar në seancë edhe persona të tjerë në dy raste, siç edhe vetë ligji e lejon: me kërkesë të gjyqtarit ose kryesisht, vetëm nëse dëgjimi i tyre është i nevojshëm për të sqaruar fakte që kanë rëndësi për procedurën e vlerësimit.

Në pikën 5 të nenit 16 është përcaktuar vendimmarrja e Këshillit duke referuar drejtpërdrejt në nenin 95 të ligjit për Statusin.

Vendimi i Këshillit publikohet në formën e një ekstrakti, sipas një forme standarde e cila respekton parashikimet e nenit 95, pika 5 të ligjit për Statusin.

Në Kreun e tretë janë përcaktuar rastet, procedura dhe rregullat e posaçme për

vlerësimin e përshpejtuar të gjyqtarit. Procedura e vlerësimit të përshpejtuar parashikohet në nenin 97 të ligjit për Statusin dhe në nenin 25, pika 3 të ligjit nr. 48/2019. Procedura e vlerësimit të përshpejtuar respekton parimet e procesit të vlerësimit dhe rregullat e përgjithshme të vlerësimit të përcaktuara në ligj dhe në këtë vendim dhe disa rregulla të posaçme shtesë që diktohen nga rastet e aplikimit të vlerësimit të përshpejtuar dhe periudhës së vlerësimit e cila është 1-vjeçare dhe përkon me vitin e fundit kalendarik.

Në nenin 17 të projektvendimit përcaktohen rastet dhe kushtet për kryerjen e vlerësimit të përshpejtuar, siç është ai paraqitjes së kërkesës së gjyqtarit dhe ai i kërkesës për transferim ngritjes në detyrë.

Në pikën 2 të nenit 17 përcaktohet se Këshilli vendos fillimin e procedurës së vlerësimit të përshpejtuar, vetëm nëse janë rastet e cituara më lart dhe vetëm nëse veprimtaria e gjyqtarit nuk është vlerësuar për dy vitet e fundit kalendarike, pas paraqitjes së kërkesës (*lapsus, pasi në relacion është 'para paraqitjes së kërkesës'*).

Është e rëndësishme të theksohet që edhe për vlerësimin e përshpejtuar është Këshilli ai që miraton programin dhe emrat e gjyqtarëve të cilët i nënshtrohen kësaj procedure vlerësimi.

Neni 18 parashikon disa rregulla më të veçanta për zhvillimin e procedurës së vlerësimit, veç miratimit të raportit.

Parashikohet gjithashtu që parashikohen afate të posaçme për kryerjen e vlerësimit nga gjyqtari dhe mendimit nga kryetari duke përcaktuar një afat 2-javor për gjyqtarin dhe një afat 1-mujor nga marrja e njoftimit për fillimin e procedurës së vlerësimit, për kryetarin për të përcjellë aktet e vlerësimit sipas nenit 88, pika 2 dhe 97 pika 3 të ligjit për Statusin. Edhe gjatë këtij harku kohor, nëpunësi përgjegjës për vlerësimin zhvillon procedurën e shortit në gjykatë sipas përcaktimeve të nenit 12 të këtij vendimi.

Mandej hartohet raporti analitik dhe merren masa... Sigurisht që ka edhe këtu ndërhyrjen e Komisionit sepse rregullat e vlerësimit të përgjithshëm zbatohen edhe për vlerësimin e posaçëm, dhe brenda një afati, i cili nuk mund të kalojë afatin 2-mujor nga përgatitja e akteve nga kryetari, relatori përgatit edhe projektraportin e vlerësimit, duke

patur parasysh që këto afate kanë qenë afate të përcaktuara në ligj, për të cilat nuk mund të disponohet ndryshe me anë të këtij vendimi.

Në pikën 5 të nenit 18 është përcaktuar detyrimi për njoftimin e projektraportit të vlerësimit gjyqtarit pasi, pavarësisht llojit të posaçëm të vlerësimit në aspektin procedural, gjyqtari ka të njëjtat të drejta për të marrë pjesë në procedim dhe për të paraqitur kundërshtimet e tij si në rastet e vlerësimit me procedurë të zakonshme.

Në pikën 6 të nenit 18 është përcaktuar përjashtimi i periudhës që i nënshtrohet vlerësimit të përshpejtuar në vlerësimin periodik, duke qenë se rregullat dhe standardet e vlerësimit gjatë vlerësimit të përshpejtuar janë të njëjta dhe nuk ka vend për përsëritjen e procedurës së vlerësimit për këtë periudhë.

Më tej, vazhdohet në vendim, me rregullimin e të drejtës së ankimit të gjyqtarit. Sipas ndryshimeve të fundit, gjyqtari ka të drejtën e ankimit të vendimit të Këshillit në Gjykatën Administrative të Apelit vetëm për shkelje të rënda procedurale.

Mandej vazhdohet me arkivimin e dosjes sipas rregullave që zbatohen në Këshill.

Kreu i pestë, i cili është një kre gjithashtu i rëndësishëm i këtij vendimi, përmban dispozitat kalimtare. Në dispozitat kalimtare janë përcaktuar rregulla që do të zbatohen për gradimin e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar në zbatim të ligjit nr. 84/2016.

Në nenin 21, pika 1 të projektvendimit është përcaktuar se periudha e rivlerësimit kalimtar nga data 08.10.2013 deri në datë 08.10.2016 do të konsiderohet periudhë vlerësimi periodik për gjyqtarët që kalojnë procesin e rivlerësimit kalimtar. Vazhdimi i procesit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve që kalojnë me sukses këtë proces, ka për qëllim vijimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit. Gjithashtu është përcaktuar se në lidhje me aftësitë organizative të gjyqtarit, vlerësimi do të bëhet duke iu referuar kritereve matëse sipas aneksit nr. 1 të vendimit të KLD nr. 261/2, datë 14.04.2010, standard që sot aplikohet edhe nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Në pikën 2 të nenit 21 parashikohet se periudha trevjeçare që përfshihet në periudhën e vlerësimit për efekt të procesit të rivlerësimit, pra vitet 2013-2016, do të

konsiderohet periudhë e plotë vlerësimi për gjyqtarin, e cila përfundon me përcaktimin e nivelit të vlerësimit që kryhet nga Këshilli. Pra Këshilli është ai që përcakton se sa dhe si vlerësohet veprimtaria e gjyqtarit, referuar niveleve “Shkëlqyeshëm”, “Shumë mirë”, “Mirë” dhe “Mjaftueshëm”. Gjithsesi Këshilli nuk mund të vlerësojë “Pamjaftueshëm” gjyqtarin që ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit.

Në pikën 3 të nenit 21 përcaktohet se, deri në përfundimin e rivlerësimit kalimtar, programi vjetor i vlerësimit që miratohet nga Këshilli merr në konsideratë, duke përfshirë me prioritet në listën e gjyqtarëve që do t’i nënshtrohet vlerësimit periodik për periudhën 2013-2016, gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe për të cilët janë përcjellë dosjet për vlerësimin profesional nga organet e rivlerësimit.

Në këtë dispozitë janë përcaktuar edhe burimet e vlerësimit për këtë periudhë, të cilat janë aktet që janë administruar për vlerësimin profesional dhe etik në procesin e rivlerësimit dhe 6 dosje të tjera shtesë që do të përzgjidhen me short me qëllim realizimin e një vlerësimi të plotë të aftësive profesionale dhe mbi baza objektive.

Në nenin 22 të projektvendimit janë përcaktuar rregulla të posaçme për vlerësimin etik dhe profesional gjatë periudhës kalimtare në zbatim të nenit 25 pika 3 të ligjit 48/2019 në të cilin parashikohet se: ”Për procedurat e transferimit paralel dhe/ose të ngritjes në detyrë të magjistratëve që kandidojnë gjatë kësaj periudhë kalimtare, Këshillat miratojnë dhe zbatojnë rregulla të posaçme për vlerësimin etik dhe profesional të tyre ...”.

Në lidhje me periudhën kalimtare gjatë se cilës zbatohet vlerësimi i përshpejtuar i detyruar, në pikën 1 të nenit 25 parashikohet si periudhë kalimtare periudha kohore deri në miratimin nga Këshillat të akteve nënligjore të vlerësimit etik dhe profesional realizimit të procedurave të vlerësimit, sipas këtij ligji, por jo më vonë se afati i caktuar për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve. Gjatë kësaj periudhe kalimtare, Këshilli bën vlerësimin e përshpejtuar, pa kërkesë të gjyqtarit, duke respektuar rregullat e vlerësimit të përshpejtuar të përcaktuara në nenin 18, por me afate të përgjysmuara.

Zhvillimi i kësaj procedure, e cila inicohet pas kërkesës së gjyqtarit për transferim ose ngritje në detyrë, në afate të përgjysmuara në raport me afatet e posaçme të

përcaktuara për procedurën e vlerësimit të përshpejtuar të përcaktuar në nenin 18 (pra atë me kërkesë), synon të garantojë zhvillimin e një procesi të shpejtë, efektiv dhe të njëjtë vlerësimi për periudhën përkatëse të vlerësimit, për të siguruar të paktën 1 vlerësim profesional në kohë, të njëjtë dhe real me atë të kërkesës së gjyqtarit për ngritje në detyrë apo lëvizje paralele.

Në nenin 23 të projektvendimit, si dispozitë kalimtare, është përcaktuar se në hartimin e programit të parë të vlerësimit, deri në zbatimin në kohën e duhur të vlerësimit etik dhe profesional, përveç vlerësimit periodik normal që përkon me periudhën e vlerësimit 2017-2019, i jepet përparësi edhe përfundimit të vlerësimit etik dhe profesional për përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit. Përcaktim i kësaj kategorie si prioritarë, përcaktohet nga vetë ligji i cili ngarkon KLGJ të bëjë gradimin me përparësi të këtyre gjyqtarëve, referuar edhe faktit që procesi i tyre i vlerësimit profesional për periudhën 2013-2016 ka filluar për shkak të vlerësimit nga organet e rivlerësimit. Pas administrimit nga KLGJ të dosjeve të vlerësimit profesional të dërguara nga organet e rivlerësimit, do të vazhdojë shorti për përzgjedhjen e 6 dosjeve shtesë dhe mbi bazën e këtyre burimeve të vlerësimit, do të përcaktohet niveli i vlerësimit të gjyqtarit. Gjithashtu, prioritarë në hartimin e programit përbën edhe përfundimi i vlerësimeve të përshpejtuara pa kërkesë, sipas nenit 21 të këtij vendimi.

Ky ishte shkurtimisht, ndoshta edhe pak në mënyrë të detajuar, relacioni lidhur me projekt-aktin që ka të bëjë me rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve.

Naureda Llagami: Shumë faleminderit zonja Ukperaj!

Atëherë, nëse kemi ndonjë diskutim mbi projekt-aktin dhe ndonjë sugjerim apo sqarim përpara se ta kalojmë në votim.

Jo! Me sa duket akti është shumë i dakordësuar dhe i ndërmjetësuar midis anëtarëve. Atëherë, e hedhim në votim projekt-aktin sipas propozimit të bërë me tekstin e propozuar nga Komisioni.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe që është pjesë përbërëse e “Skemës së vlerësimit të gjyqtarëve”. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 21.11.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarëve”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:45 dhe mbaroi në orën 13:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |

11. Marçela Shehu

(anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.**
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.**
- 7. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 8. Vjollca Kola, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 9. Elsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 10. Rudina Palloj, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 11. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 12. Anisa Kuqi, EURALIUS.**
- 13. Julinda Beqiraj, EURALIUS.**
- 14. Klodian Rado, EURALIUS.**
- 15. Erion Fejzulla, USAID.**
- 16. Gregor Borkowski, EURALIUS.**
- 17. Chuck Ericksen, USAID.**

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarëve””, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin tjetër që Këshilli do marri për shqyrtim. Edhe ky ka të bëjë me skemën e vlerësimit, që bëhet fjalë për “Miratimin e metodologjisë së pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarëve”, edhe ky akt përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe që do relatohet nga zonja Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Atëherë, akti i dytë që plotëson skemën e vlerësimit të gjyqtarëve, titullohet “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”.

Në kuadër të plotësimit të kuadrit nënligjor të skemës së vlerësimit të gjyqtarëve, iu paraqitet sot për miratim në mbledhje plenare ky projekt-akt si pjesë përbërëse e skemës së vlerësimit dhe ka për qëllim, shpjegimin e mënyrës se si përcaktohet niveli i vlerësimit të gjyqtarit, për secilin kriter të vlerësimit të përcaktuar në ligji.

Kjo metodologji është vlerësuar e nevojshme për të kryer një vlerësim sa më objektiv të gjyqtarit, i bazuar në një sistem pikësh, që caktohen mbi bazën e një analize të të dhënave të dala nga burimet e vlerësimit, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Duke mbajtur në konsideratë parashikimet ligjore dhe rekomandimet e Komisionit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian, kjo metodologji vendos kritere objektive të cilat do të publikohen. Qëllimi i saj nuk është të shprehurit e rezultateve të vlerësimit me shifra, përqindje apo renditja e gjyqtarëve pa shpjegime të mëtejshme, pasi kjo do të krijonte përshtypje të rremë për objektivitetin dhe sigurinë. Komisioni Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian i nxit vendet anëtare të mos u japin gjyqtarëve vlerësime të këqija, duke u bazuar në kushtet e këqija të punës së tyre, për të cilat ata nuk kanë asnjë gjë në dorë. Mbi këtë bazë edhe ligji për Statusin parashikon një vlerësim të bazuar në kritere objektive dhe shqyrtime objektive, çka reflektohet në metodologji në mënyrën se si

arrihet tek niveli i vlerësimit.

Për këtë qëllim, në hartimin e metodologjisë janë mbajtur parasysh kriteret, burimet dhe nivelet e vlerësimit të përcaktuar në ligjin për Statusin. Në hartimin e sistemit të pikëzimit për çdo aspekt dhe tregues të parashikuar në ligj, është mbajtur parasysh pesha specifike e secilit indikator vlerësimi.

Në ligjin për Statusin, vlerësimi i gjyqtarit bëhet bazuar në katër kriteret të përcaktuara: “Aftësitë profesionale”; “Aftësitë organizative”; “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”; “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional i gjyqtarit”.

Në metodologji është përcaktuar që niveli i vlerësimit për çdonjërin nga kriteret e vlerësimit, do të përcaktohet mbi bazën e një shkalle pikëzimi nga 1 deri në 100 pikë.

Në metodologjinë e pikëzimit, referuar nenit 78, pika 1 të ligjit për Statusin, janë përcaktuar pesë nivele vlerësimi. Aplikimi i niveleve të vlerësimit i është referuar kombinimeve për çdo kriter vlerësimi, sipas përcaktimit që bën ligji dhe konkretisht në nenin 78 pika 2, 3, 4 dhe 5 të tij.

Duke qenë se në ligj nuk janë parashikuar të gjitha kombinimet e mundshme të niveleve të vlerësimit për secilin nga katër kriteret e vlerësimit, në metodologji është parashikuar krijimi i një mekanizmi për përcaktimin e nivelit të përgjithshëm të vlerësimit në rastet që nuk përfshihen në rregullimin e nenin 78 të ligjit. Konkretisht, metodologjia parashikon se për çdo kombinim të ndryshëm nga ato të parashikuara nga ligji, niveli i përgjithshëm i vlerësimit do të përcaktohet duke marrë për bazë mesataren e pikëve për të katër kriteret, sipas shkallës së pikëzimit që përcakton metodologjia, por gjithsesi ky pikëzim nuk mund të përcaktojë një nivel të përgjithshëm vlerësimi më të lartë, se niveli i vlerësimit për kriteret “Aftësitë profesionale” dhe “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit”. Parashikimi i këtij kriteri specifik për përcaktimin e nivelit të përgjithshëm të vlerësimit sipas pikëzimit, është përcaktuar duke iu referuar peshës specifike që ligjvënësi i ka dhënë këtyre dy kriterëve në raport me dy kriteret e tjera, rëndësi kjo e cila rezulton e qartë jo vetëm nga indikatorët që përcaktojnë këto dy kriteret vlerësimi dhe rëndësisë së posaçme të tyre në vlerësimin e gjyqtarit, por edhe prioritetit dhe rolit përcaktues që i ka dhënë vetë ligji në pikat 2, 3, 4, 5 të nenit 78 të tij.

Sipas metodologjisë, në zbatim të ligjit për Statusin, niveli i vlerësimit të gjyqtarit, përcaktohet më vete, për secilin nga katër kriteret e përcaktuara në ligj, bazuar në një shkallë pikëzimi nga 1 deri në 100 pikë. Shkalla e pikëzimit që përcakton metodologjia paraqitet si më poshtë:

- 70 deri në 100 pikë – niveli “Shkëlqyeshëm”;
- 50 deri në 89 pikë – niveli i vlerësimit “Shumë mirë”;
- 30 deri në 69 pikë – niveli i vlerësimit “Mirë”;
- 30 deri në 49 pikë - niveli i vlerësimit “Mjaftueshëm”;
- 1 deri në 29 pikë – niveli i vlerësimit “Pamjaftueshëm”.

Për lehtësi përdorimi të çdo vlerësuesi, metodologjia përmban një pasqyrë përmbledhëse të katër grup kriterëve, me aspektet e treguesit e secilit, bashke me sistemin e pikëve të aplikuar.

Me qëllim përdorimin dhe kuptimin e njëjtë të termave gjatë zbatimit dhe interpretimit të skemës së vlerësimit dhe metodologjisë së pikëzimit, janë përkufizuar edhe termat kryesorë që përdoren në akt.

Referuar kriterit të parë “Aftësisë profesionale të gjyqtarit” i cili në total duhet të vlerësohet me 100 pikë – Në vlerësim të këtij kriteri, në referim të nenit 72 të ligjit për Statusin, vlerësojmë dy aspekte, secili me nga 50 pikë. Këto aspekte përbëhen nga tregues specifikë për të cilët parashikohet një sistem pikëzimi dhe vlerësimi specifik, referuar rëndësisë së secilit tregues.

Për të vlerësuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit, referuar burimeve të vlerësimit, duke mos vlerësuar meritat ligjore, pra duke mos vlerësuar elementë që kanë të bëjnë me bindjen e brendshme të gjyqtarit dhe aspekte të zbatimit të ligjit që janë lëndë e vlerësimit të çështjes nga gjykata më e lartë, se do të kishim në të kundërt cenim të pavarësisë së gjyqtarit. Në vlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtarit vlerësuesi çmon dhe pikëzon vetëm aftësinë gjyqësore të gjyqtarit duke mos vlerësuar elementë që kanë të bëjnë me themelin e çështjes si dhe korrektësinë e interpretimin e ligjit në vendim.

Ky kriter përbëhet nga aspekti i “Njohurive ligjore”, 50 pikë dhe aspekti i “Arsyetimit ligjor”, i cili po ashtu ka 50 pikë. Aspekti i “Njohurive ligjore” zbërthehet në disa tregues: Aftësinë e gjyqtarit për identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, në të cilin në metodologji shpjegohen cilat janë burimet e vlerësimit dhe si bëhet pikëzimi i këtij kriteri sipas një numri pikësh në 5 shkallë (“E dobët”, “Nën mesatare”, “Mesatare”, “Mbi mesataren” “Shumë e lartë”) duke bërë një detajim të pikëve nga 5 deri në 25.

Treguesi i dytë ka të bëjë me “Aftësinë e gjyqtarit për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, i cili pikëzohet referuar mënyrës së zbatimit të ligjit mbi faktet e çështjes konkrete. Sipas metodologjisë, referimi formal i ligjit, i pa shoqëruar me analizën e tij, raportin midis dispozitave dhe aplikimin e normës mbi faktet konkrete të çështjes, nuk tregon aftësi të gjyqtarit për të interpretuar ligjin në referim të këtij treguesi dhe mund të jetë tregues i mungesës së këtyre aftësive.

“Aftësia e gjyqtarit për të zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës”, është një tjetër aspekt që vlerësohet në kuadër të këtij treguesi, pasi këto parime kanë lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit që ndikojnë në zgjidhjen e çështjes konkrete. Në këtë këndvështrim vlerësohet aftësia e gjyqtarit për zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete dhe jo thjesht përmendja e tyre në vendim.

Vlerësohet aftësia e gjyqtarit pikërisht në kuadër të treguesit të dytë, për të identifikuar, organizuar dhe përdorur jurisprudencën përkatëse, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete. Vlerësohet sa dhe si gjyqtari identifikon praktikën gjyqësore vendase dhe ndërkombëtare, në mbështetje të një vendimi ose interpretimi të caktuar, si dhe përdor dhe krahason burime jurisprudenciale nga sistemi ligjor vendas dhe nga sisteme të tjera. Në veçanti, vlerësohet nëse gjyqtari i referohet, në vendin e duhur dhe të qëllimit të aktit praktikën e konsoliduar gjyqësore, praktikën e unifikuar dhe të njësuar të Gjykatës së Lartë, praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së dhe të gjithë jurisprudencën, edhe në rastet kur ajo nuk përbën burim të së drejtës, por i shërben interpretimit të ligjit në kuadër të përafrimit të legjislacionit.

Mandej parashikohet pikëzimi i këtij treguesi me 25 pikë dhe burimet e vlerësimit sipas një sistemi pikësh nga 5 deri 25.

Aspekti i dytë është ai i “Arsyetimit ligjor”, parashikon një nivel maksimal prej 50 pikësh dhe ndahet në vlerësimin e “Qartësisë, konçizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit”, që ka të bëjë konkretisht me vlerësimin e aftësive për të krijuar një vendim të kuptueshëm dhe të lexueshëm për të gjithë përdoruesit.

Treguesi i dytë ka të bëjë me “Strukturën e qëndrueshme dhe të organizuar të vendimit”. Vlerësohet në veçanti në varësi të këtij treguesi ndjekja e një metodologjie të caktuar në funksion të orientimit të saktë të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së dokumentit.

Treguesi i tretë ka të bëjë me “Cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik”. Është një tregues i rëndësishëm ku edhe puna e vlerësuesit është delikate sepse përcakton shtrirjen sa dhe si do të bëhet kjo cilësi analize, pa cenuar bindjen e brendshme të gjyqtarit. Prandaj në metodologji është përcaktuar që për pikëzimin e këtij treguesi vlerësohet cilësia e analizës dhe paraqitja e saj mbi bazën e një zhvillimi logjik të koncepteve ligjore. Argumentimi logjik nënkupton aftësinë e gjyqtarit për të identifikuar marrëdhëniet shkak-pasojë, si edhe për të analizuar se si konceptet, institutet dhe dispozitat lidhen midis tyre, ose se si ato zbatohen në një situatë të caktuar. Në veçanti në këtë tregues vlerësohet nëse niveli i arsyetimit plotëson standardin e procesit të rregullt ligjor dhe nëse përmbajtja e dokumentit është gjithëpërfshirëse, duke u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve. Përcaktohen burimet e vlerësimit dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit me një sistem pikëzimi nga 5 deri në 25 pikë.

Kriteri i dytë është “Aftësia organizative e gjyqtarit”. Vlerësimi i këtij kriteri nxit gjyqtarin të jetë efektiv në organizimin, menaxhimin dhe kontrollin e procedurave gjyqësore, në drejtim të rritjes së efikasitetit në dhënien e drejtësisë.

Aspektet e këtij kriteri pikëzohen si më poshtë: Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë pikëzohet në total me 50 pikë; Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore pikëzohet në total me 35 pikë dhe; Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore pikëzohet në total me 15 pikë.

Referuar aspektit të parë, treguesit që vlerësojnë “Aftësinë e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë” janë: ai i “Respektimit të afateve ligjore”. Në këtë rast vlerësimi bëhet mbi bazën e raportit midis numrit të çështjeve të gjykuara tej afatit ligjor me numrin total të çështjeve të gjykuara brenda periudhës së vlerësimit, duke marrë parasysh vetëm numrin e çështjeve për të cilat ligji parashikon afate gjykimi. Edhe për këtë tregues në metodologji është përcaktuar që vlerësimi të jetë logjik dhe jo të jetë thjesht mbi analizë matematikore.

Treguesi i dytë ka të bëjë me “Plotësimin e standardeve minimale kohore”. Janë standarde kohore që i vendos Këshilli i Lartë Gjyqësor me anë të një vendimi tjetër, që do të plotësojë edhe ai skemën e vlerësimit. Edhe këtu vlerësimi bëhet mbi bazën e shqyrtimit të të dhënave statistikore, por jo thjesht një analizë matematikore por logjike edhe me kushtet e tjera të punës së gjyqtarit.

Treguesi i tretë ka të bëjë me “Kohën mesatare që i dedikohet do çështjeje”. Shpjegohet qartë në metodologji mënyra se si pikëzohet dhe si identifikohet koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje dhe pikëzimi i saj.

Treguesi i katërt ka të bëjë me “Rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore”. Edhe në metodologji por edhe për shkak të përkufizimit që ligji i jep rendimentit, vlerësohet raporti midis çështjeve të përfunduara nga gjyqtari brenda të njëjtit vit kalendarik me çështjet që i caktohen të njëjtit vit gjyqtarit. Është përcaktuar në metodologji që analiza e të dhënave statistikore të mos jetë thjesht formale por të vlerësohen edhe kritere të tilla si kompleksiteti i çështjeve, volumi, aspekte që lidhen me kushtet e punës, rritja e papritur e volumit të çështjeve të regjistruara, të tilla që mund të çojnë në një pikëzim maksimal, vetëm nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës të përcaktuar me vendim të Këshillit.

Treguesi i pestë ka të bëjë me “Kohën mesatare të arsytimit të vendimit gjyqësor” edhe ky një tregues i rëndësishëm sepse është element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor dhe vijimit të procesit të ankimimit të vendimit.

Aspekti i dytë ka të bëjë me “Aftësinë për të kryer procedura gjyqësore”, përsëri brenda kriterit të dytë. Vlerësohet mbi bazën e dy treguesve: numrit mesatar të seancave

gjqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive i cili pikëzohet me 15 pikë. Në metodologji shpjegohet në mënyrë të hollësishme si bëhet analiza e numrit të seancave krahasuar veprimeve të vetë gjyqtarit për shmangien e atyre joproductive; dhe treguesi i dytë është kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, e cili pikëzohet me 20 pikë.

Në metodologji, për të dy këto tregues janë të përcaktuar burimet e vlerësimit dhe mënyra se si bëhet pikëzimi.

Aspekti i tretë është “Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore”. Përbëhet nga dy tregues:

Treguesi i parë ka të bëjë me “Rregullshmërinë e dokumentacionit”, ndërsa i dyti ka të bëjë me “Saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit në dosje”, sipas një sistemi pikësh të përcaktuar bazuar në peshën specifike të secilit kriter.

Kriteri i tretë, dhe ai shumë i rëndësishëm, sikundër edhe ai i “Aftësive profesionale”, është “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit”.

Në metodologji është përcaktuar që pikëzimi i treguesve të këtij kriteri vlerësimi të bëhet sipas një rendi zbritës, mbi bazën e prezumimit dhe bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e 100 pikëve referuar këtij kriteri të vlerësimit. Gjatë procedurës së vlerësimit, pikët mund të zbriten në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues të dalë nga burimet e vlerësimit krahasuar me ligjin, standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes të miratuara nga KLGJ.

Ky kriter ndahet në tre aspekte kryesore: “Etika në punë”, “Integriteti i gjyqtarit” dhe “Paanësia e gjyqtarit”. Për secilin nga aspektet janë përcaktuar burimet e vlerësimit. Është përcaktuar shkalla e pikëzimit. Vlen të theksohet për aspektin e dytë “Integriteti i gjyqtarit”, ka vetëm dy shkallë pikëzimi sepse integriteti është një çështje për gjyqtarin, integriteti është absolut, integriteti është më shumë se virtyt, ai është domosdoshmëri. Prandaj, shkalla e integritetit të gjyqtarit, nëse vlerësohet e dobët ai do të vlerësohet 0 pikë dhe nëse është e lartë ai do të marri 40 pikë, gjithmonë mbi bazën e prezumimit të

këtij treguesi.

Të dhënat e dala nga burimet e vlerësimit analizohen nga vlerësuesi në mënyrë objektive duke shmangur qëndrimin subjektiv të tij apo edhe të anëtarit të Këshillit të krijuar mbi bazën e njohjeve personale me gjyqtarin.

Aspekti i tretë është “Paanësia e gjyqtarit” vlerësohet me 25 pikë mbi bazën e “Përdorimit ose jo të gjuhës diskriminuese”, që është treguesi i parë dhe “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”. Tek treguesi i dytë është bërë një vlerësim i detajuar i asaj që kush do t’i quhet numër tejet i lartë i kërkesave, duke vlerësuar jo vetëm numrin e vendimeve të përjashtimit por edhe qëndrimin e gjyqtarit nëpërmjet kërkesave për heqje dorë të paraqitura por të papranuara nga na e kryetarit të gjykatës.

Kriteri i katërt është “Aftësia personale dhe angazhimi profesional i gjyqtarit”. Vlerësohet sipas aspektit të “Aftësisë së komunikimit”, i cili ndahet në treguesin e parë të “Komunikimit të qartë dhe transparent” (25 pikë), treguesin e dytë “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtës së të dhënave personale” (15 pikë).

Aspekti i dytë “Aftësia për të bashkëpunuar” pikëzohet në total 25 pikë dhe ndahet në treguesin e parë të “Shkallës së komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale” (15 pikë), dhe “Shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” (10 pikë). Për të dy këto tregues të këtij aspekti është parashikuar në mënyrë të detajuar mënyra e vlerësimit, burimet e vlerësimit dhe shkalla e pikëzimit.

Aspekti i tretë dhe i fundit i këtij treguesi ka të bëjë me “Gatishmërinë gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera” (35 pikë).

Ky aspekt vlerësohet mbi bazën e katër treguesve të cilët janë pikëzuar në mënyrë të diferencuar duke i dhënë peshë specifike nëpërmjet vlerësimit me 20 pikë treguesit të parë që ka të bëjë me “Pjesëmarrjen e gjyqtarit në aktivitete trajnuese” duke qenë se përbën detyrim ligjor të gjyqtarit.

Gjithashtu është përcaktuar vlerësimi me 5 pikë për secilin nga tre treguesit e tjerë duke synuar vlerësimin dhe nxitjen e gjyqtarëve që kryejnë veprimtari të tjera, paralelisht

ose jashtë funksioneve gjyqësore, por duke pasur kujdes për të mos penalizuar në përcaktimin e nivelit të vlerësimit etik dhe profesional, gjyqtarët që nuk kanë mundësi objektive për të ushtruar veprimtari të kësaj natyre sepse jo gjithmonë përzgjedhja është në varësi të vullnetit të gjyqtarit.

Treguesi i parë pra “Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet trajnuese” është 20 pikë. Sipas metodologjisë dhe shkallës së pikëzimit.

Treguesi i dytë “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për magjistratë” (5 pikë).

“Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në marrëdhëniet me publikun të gjykatave” (5 pikë).

Dhe treguesi i katërt “Publikimet ligjore akademike” (5 pikë).

Në fund të metodologjisë janë përcaktuar edhe burimet e vlerësimit të përcaktuara në ligj.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Kemi ndonjë diskutim?

Jo!

Atëherë, e kalojmë projekt-aktin në votim sipas propozimit të bërë nga Komisioni?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Miratimin e metodologjisë së pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë e “Skemës së vlerësimit të gjyqtarëve”. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 21.11.2019)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përjashtimin e gjyqtarës {...} nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:45 dhe mbaroi në orën 13:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 7. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 8. Vjollca Kola, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Elsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Rudina Palloj, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 11. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 12. Anisa Kuqi, EURALIUS.*
- 13. Julinda Beqiraj, EURALIUS.*
- 14. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 15. Erion Fejzulla, USAID.*
- 16. Gregor Borkowski, EURALIUS.*
- 17. Chuck Ericksen, USAID.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përjashtimin e gjyqtares {...} nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e tretë të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për përjashtimin e gjyqtares {...} nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme. Ky projekt-akt është përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Do ta relatojë zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor më datë 08.11.2019, është regjistruar kërkesa e gjyqtares {...}, në detyrë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, me anë të së cilës kërkon përjashtimin nga delegimet. Nëpërmjet kësaj kërkesë gjyqtarja kërkon të përjashtohet nga delegimet (caktimi në gjykata të tjera për të gjykuar çështje gjyqësore të veçanta), për arsye shëndetësore të saj dhe të vajzës së mitur. Gjyqtarja shprehet se për shkak të problemeve në shtyllën kurrizore, nga ana e mjekut specialist i është rekomanduar evitimi i udhëtimeve të gjata dhe qëndrimi ulur. Gjithashtu, sipas saj, bashkëshorti, për arsye pune, në pjesën më të madhe të vitit nuk ndodhet në pranë familjes, çka e bën të vështirë përkujdesjen për vajzën e mitur, e cila përveç të tjerash vuan edhe ajo nga një sëmundje që sipas akteve mjekësore të referuara dhe të paraqitura nga ana e gjyqtares është “dispalzia koksofemorale”. Për këto problemet shëndetësore të saj dhe të fëmijës, ka paraqitur edhe aktet mjekësore që janë: Vërtetim të KMCAP-i Tiranë. Po kështu edhe raport mjekësor të lëshuar nga mjeku që ndjek pacienten {...} si dhe një shkresë nga ana e Spitalit Rajonal Durrës.

Vlen të mbahet parasysh se gjyqtarja {...} edhe më parë, me kërkesën e datës 09.11.2018, i ka kërkuar ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë përjashtimin e saj nga procesi i delegimeve për shkaqe shëndetësore. Në këtë rast, ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me

vendimin nr. 54, datë 19.11.2018, ka vendosur të pranojë si të bazuar kërkesën e gjyqtarës në fjalë dhe ta përjashtojë atë deri në 6 muaj nga lista e gjyqtarëve që delegoheshin.

Po ashtu, e njëjta kërkesë është përsëritur nga gjyqtarja {...} edhe përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili me vendimin nr. 73, datë 20.05.2019, ka vendosur përjashtimin e gjyqtarës në fjalë nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, për një afat 6-mujor, afat ky që përfundon më datë 20 nëntor të vitit 2019.

Rregullat për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, janë miratuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 14.02.2019. Në këto rregulla, në paragrafin e VIII, ku flitet për përjashtimin e gjyqtarit nga ky proces, në pikën 6 të tij, parashikohet se: “Me kërkesë të motivuar të gjyqtarit dhe të shoqëruar me aktet e nevojshme provuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor, për arsye shëndetësore, mund të vendosë përjashtimin gjer në gjashtë muaj të një gjyqtari nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta”.

Sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë se gjyqtarja {...} ka paraqitur kërkesë të motivuar dhe të shoqëruar me aktet e nevojshme që vërtetojnë gjendjen e saj shëndetësore dhe të fëmijës së saj, konform pikës 6, paragrafit VIII, të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 14.02.2019, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon përjashtimin për një afat 6 muaj të gjyqtarës nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.

Për këtë është paraqitur edhe një projektvendim që parashikon pikërisht këtë gjë:
“1. Përjashtimin e gjyqtarës znj. {...}, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, për një afat 6 muaj. 2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.”
Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim përpara se ta kalojmë projekt-aktin për votim?
Atëherë, e hedhim në votim projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

Maksim Qoku: Dakord.

(Vota e zonjës Kadi nuk dëgjohet.)

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: “1. Përjashtimin e gjyqtares znj. {...}, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, për një afat 6-mujor. 2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 21.11.2019)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:45 dhe mbaroi në orën 13:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 7. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënive me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 8. Vjollca Kola, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Elisma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Rudina Palloj, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 11. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 12. Helios Reveli, EURALIUS.*
- 13. Rezart Alija, EURALIUS.*

RENDI I DITËS:

4. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër që do marri në shqyrtim Këshilli i

Lartë Gjqësor, që ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme. Lidhur me relativimin e këtij projekt-akti, fjalën ia jap kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, zotit Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, Komisioni vlerësoi të paraqesë përpara Këshillit në këtë mbledhje vetëm disa nga kërkesat që janë paraqitur pranë Këshillit për caktimin e gjyqtarëve për çështje të ndryshme gjyqësore në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme. Janë disa kërkesa që janë të karakterit urgjent apo tepër urgjent. Si të tilla, pavarësisht se një javë më parë ne organizuam një procedurë të tillë, u çmua që të trajtohen nga Këshilli në këtë mbledhje gjyqësore.

Atëherë, janë 4 kërkesa: një kërkesë e Gjykatës së Apelit Durrës, një e Gjykatës së Apelit Korçë, një e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda dhe një kërkesë nga Gjykata e Lartë.

Referuar radhës që përmenda më lartë, është edhe propozimi i parë për të ndjekur procedurat e shortit. Nuk e di nëse janë dakord anëtarët që të vazhdojmë me këtë radhë të procedurave të shortit?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Mirë atëherë, do duhet të vazhdojmë me shortin elektronik.

(Ka një pauzë të shkurtër për shkak të bërjes gati të shortit elektronik.)

Mirë atëherë, fillimisht po parashtoj propozimet sa i përket **Gjykatës së Apelit Durrës**. Kërkesa urgjente që ka paraqitur lidhet me një çështje penale, kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve. Është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, si kundra është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i aplikueshëm zbatimi i vendimit të Këshillit të Lartë Gjqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, ku referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të

veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2.

Në këtë rast janë edhe disa propozime të mëtejshme që kanë të bëjnë me përjashtimin nga shorti, konkretisht të përjashtohet nga shorti, referuar rregullores së Këshillit, që përmenda më lartë, zëvendëskryetari i kësaj gjykate, zoti {...}; gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë që është njëkohësisht edhe anëtar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, zoti {...}; gjyqtarët e kësaj gjykate që janë me leje afatgjatë nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, zonja {...} dhe zoti {...}; gjyqtari i kësaj gjykate që ka depozituar kërkesë për dorëheqje nga statusi i magjistratit, zoti {...}; gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë të cilët janë caktuar më herët për gjykimin e 12 apo më shumë çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme që janë zoti {...}, zonja {...}, zonja {...} dhe zonja {...}; po kështu të përjashtohen nga shorti dhe gjyqtarët që një javë më parë i caktuam në Gjykatën e Apelit Korçë dhe në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, që janë zoti {...}, zonja {...}, zoti {...}, zonja {...}, zoti {...}, zonja {...} dhe zoti {...}.

Nëse jeni dakord me këto propozime mund të vijojmë.

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, janë reflektuar në sistemin elektronik të gjitha propozimet që u miratuan nga Këshilli, Do duhet të procedojmë me shortin.

Valbona Bako: Gjyqtarët {...} dhe {...}.

Ilir Toska: Atëherë, për çështjen në Gjykatën e Apelit Durrës, shorti përzgjedhi në mënyrë elektronike gjyqtarët {...} dhe {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Durrës.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Korçë**. Gjykata e Apelit Korçë ka paraqitur një kërkesë për 1 çështje penale. Kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit të gjyqtarëve, si kundra dhe është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve. Ndërkohë që referuar vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë

tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Në këtë rast, duke patur në konsideratë formimin më herët të trupit gjykues në çështjen për të cilën është paraqitur një kërkesë dhe për ekonomizim të burimeve njerëzore, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, propozon që për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short ndërmjet gjyqtarëve të Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë të caktuar në shortin e datës 12 nëntor 2019, për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë, konkretisht ndërmjet gjyqtarëve {...} dhe {...}, ndërsa gjyqtari tjetër {...} nuk mund të caktohet serish për shkak se është në përbërje të trupit gjykues që po gjykon këtë çështje. Pra do duhet të përjashtojmë në këtë rast zotin {...} në shortimin e çështjes dhe shorti të zhvillohet mes dy gjyqtarëve {...} dhe {...}. Jeni dakord me këtë propozim?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Mirë atëherë, procedojmë me shortin elektronik.

Valbona Bako: {...}.

Ilir Toska: Mirë atëherë, për 1 çështje të Gjykatës së Apelit Koçë caktohet gjyqtarja {...}. Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Korçë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda**. Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda ka paraqitur një kërkesë me anë të së cilës kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve në 1 çështje gjyqësore. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizimi i skemës së delegimit si dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve. Ndërkohë që bazuar në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë

Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje, të jetë 2.

Në rast të pranimit të propozimit si më lart, për ekonomizim të burimeve njerëzore, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni propozon që për 1 çështje gjyqësore, për të cilën kërkohen 2 gjyqtarë, si të përzgjedhur nga shorti të konsiderohen dy gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë të caktuar, me shortin e datës 12 nëntor, pra të shortit para një jave, për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, konkretisht gjyqtarët {...} dhe {...}. Pra propozohet që të konsiderohet rezultati i shortit elektronik të datës 12, meqenëse janë caktuar dy gjyqtarët vetëm në 1 çështje. Të ricaktohen edhe për këtë çështjen në nevojë të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda.

Nëse jeni dakord.

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Mirë atëherë, në këtë rast nuk ka nevojë të ribëjmë një procedurë shorti, duke konsideruar shortin elektronik të datës 12 nëntor. Për gjykimin e 1 çështjeje në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda caktohen gjyqtarët {...} dhe {...}. Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda.

Vazhdojmë me çështjet në nevojë në **Gjykatën e Lartë**. Ka paraqitur kërkesë për 1 çështje gjyqësore që ka të bëjë me ekstradimin. Kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve. Lidhur me këtë, Komisioni siç kundër në të gjitha rastet e tjera të mëhershme, referuar nevojave të Gjykatës së Lartë, propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda. Gjyqtarët për 1 çështje gjyqësore të veçantë, të përzgjidhen, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016. Ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2, aq sa është nevoja në atë gjykatë.

Lidhur me gjyqtarët që plotësojnë kriteret si më lart, janë gjyqtarët {...} ... {...}.

Dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Mirë atëherë, procedojmë me shortin elektronik.

Valbona Bako: Gjyqtarët {...} dhe {...}.

Ilir Toska: Atëherë, nga rezultati i shortit elektronik, caktohen për në Gjykatën e Lartë, për të gjykuar 1 çështje gjyqësore që ka të bëjë me ekstradim, gjyqtarët {...} dhe {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Me kaq mbyllim mbledhjen për sot. Faleminderit!

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor